



Telekomi i Kosovës ShA

Në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-212-Ligji i Punës, nenit 8, nenit 10, pika 2 (2.3) dhe neni 19 pika 4 i Rregullores mbi Marrëdhënien e Punës, Nr.01-2978/22, të datës 27/06/2022, ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr.01-2978/22, të datës 28/03/2022, Telekom i Kosovës ShA, shpall:

KONKURS PUBLIK për Punë dhe Detyra Specifike

Titulli i punës: Ekspert ligjor (1 ekzekutues).

Për shërbime ligjore dhe shërbime tjera përcjellëse, përkrahje dhe/ose përfaqësim në raste komplekse komerciale pranë gjykatave vendore që mund të kenë elemente ndërkombëtare si dhe të rasteve tjera të natyrës së ndryshme juridike.

Afati i fundit për aplikim: 14.07.2023

Përshkrimi i punës, përgjegjësitë dhe detyrat profesionale:

- Mbështetë personelin e brendshëm të Telekomit të Kosovës ShA, dhe bën përfaqësim juridik në rastet komplekse komerciale që mund të kenë elemente ndërkombëtare (njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja), dhe, atë vetëm në pjesën e materies që i referohet zbatimit të legjislacionit të Republikës së Kosovës.
- Mbështetë personelin e brendshëm të Telekomit të Kosovës ShA., dhe bën përfaqësim juridik në të gjitha fazat në procesin e rasteve komplekse komerciale, duke përfshirë edhe mbështetjen dhe përfaqësimin e Telekomit të Kosovës ShA, pranë gjykatave në territorin e Republikës së Kosovës.
- Mbështetë personelin e brendshëm të Telekomit të Kosovës Sh.A. në veprimet juridike dhe bën përfaqësim juridik në raste që mund të përmbajnë edhe klauzola të arbitrazhit, apo në procedura gjyqësore që ndërlidhen me marrëveshje të arbitrazhit (kompetenca, njohja dhe përmbartimi i vendimeve të arbitrazhit) dhe të ngjashme.
- Mbështetë personelin e brendshëm të Telekomit të Kosovës ShA, dhe bën përfaqësim në çështjet e punës, çështjet civile, çështjet penale dhe ato administrative, në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, Gjykatën Supreme të Kosovës, Gjykatën e Apelit dhe gjykatat e rregullta.
- Mbështetë personelin e brendshëm të Telekomit të Kosovës ShA, në dhënien e opinioneve ligjore në materie të kontratave komerciale nga lëmi i telekomunikacionit dhe fushave tjera relevante për Telekomin e Kosovës ShA.
- I përgjigjet Drejtorit për Çështje të Korporatës, Menaxherit të Departamentit për Çështje Juridike dhe Kryeshefit Ekzekutiv të Telekomit të Kosovës ShA.

- Kryen punë dhe detyra të përkrahjes në standardet më të larta profesionale dhe përgjegjësi maksimale në mbrojtjen e interesave të Telekomit të Kosovës ShA.
- Është përgjegjës që veprimet juridike të kryhen në afatet ligjore, ose afatet e indikuara/caktuara nga Gjykata ose organet kompetente.
- Duhet të posedojë ekspertizë në kërkimin dhe analizimin e legjislacionit vendor dhe rajonal, dhe ndikimin e tyre në çështje të ngjashme.
- Sipas nevojave për kryerjen e punëve eksperti i angazhuar duhet të punojë nën presion kohor dhe duke i respektuar kërkesat dhe afatet e parashtruara nga punëdhënësi që nënkupton edhe angazhimin jashtë orarit të rregullt të punës.
- Punët tjera sipas kërkesës së punëdhënësit.

Kushtet dhe kualifikimet për angazhimin në punë dhe detyra specifike:

- Përgatitje profesionale universitare – jurist i diplomuar.
- Përvojë të dëshmuar profesionale së paku 5 vite në procese të veprimeve juridike, posaçërisht raste komplekse komerciale me element të huaj dhe/ose arbitrazhe në së paku në 1(një) rast.
- Preferohet provimi i jurisprudencës dhe specializime përkatëse në lëmi komerciale.
- E preferuar: përvoja e dëshmuar në raste komerciale me element të huaj në gjykata vendore apo ndërkombëtare (duke përfshirë arbitrazhin).
- Me preferencë të lartë është njohja e dëshmuar e gjuhës angleze ose ndonjë gjuhë tjetër e BE-së.
- Njohja e mirë e materies së raporteve komerciale-kontratave, kontratave me element të huaj, përgatitja e opinionëve legale, etj.
- Njohje e mirë e tregut dhe industrisë së telekomunikacionit.
- Njohuri të mira të përpilimit të raporteve informative të punëve për të gjitha strukturat e korporatës.
- Aftësi analitike për të kuptuar dhe shpjeguar ide dhe probleme të ndërlikuara në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme.
- Duhet të posedojë ekspertizë në kërkimin dhe analizimin e legjislacionit vendor dhe rajonal, dhe ndikimin e tyre në çështje të ngjashme.

5

Aftësitë tjera: Shkathtësi të forta ndër personale me aftësi për t'u ndihmuar grupeve të ndryshme drejtë efikasitetit operativ; puna në ekip dhe puna nën presion janë të vlerës së madhe për punëdhënësin; shkathtësi të forta analitike për zgjidhjen e problemeve dhe aftësi organizative.

Periudha e angazhimit bëhet me Kontratë për punë dhe detyra specifike për 120 ditë.

Pagesa bëhet në bazë mujore sipas marrëveshjes në harmoni me vendimet e brendshme të korporatës.

Mënyra e aplikimit:

Kandidatët e interesuar duhet ta plotësojnë Aplikacionin zyrtar për Punësim që merret në web faqen zyrtare të internetit në adresën: www.kosovotelecom.com

Kandidatët, aplikacionit duhet bashkëngjitur:

- Biografi (CV);
 - Letër motivuese;
 - Dëshminë për kualifikimet arsimore (diplomë përkatëse);
 - Dëshmi mbi përvojën e punës;
 - Kopjet e certifikatave/trajnimeve relevante të kryera (nëse ka);
- ☐ Aplikacionet duhet të dorëzohen në ndërtesën kryesore të Telekomit të Kosovës në Prishtinë, Dardania, kati gjashtë, zyra e arkivit.
 - ☐ Afati i fundit për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit, përkatësisht deri më 14.07.2023.
 - ☐ Aplikacionet mund të parashtrihen në njërin prej gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen. Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara, pa dëshmi).
- ☐ Kandidatët që i plotësojnë kriteret e kërkuara do të ftohen në test/intervistë.